



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 700/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj, Kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Vehbi Rama, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Viti, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Vehbi Rama, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Viti, me shenjën ZL.Anr.700/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017 në ora 15:05, nga Vehbi Rama, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Viti, me të cilën pretendon se në Komunën e Vitisë, në Qendrat e Votimit QV nr. 2605D/01R, 2605D/02R, 2605D/03R, 2605D/04R, 2605D/04D, 2617D/01R, 1267D/02R, 2617D/03R, 2617D/04D, 2609D/01R, 2609D/02R, 2609D/03D, 2608D/01R, 2608D/02R, 2614D/01D, 2615D/01D, 2626D/01D, 2623D/01R ka pasur pa rregullsi gjatë numërimit të votave .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në apelin e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në Komunën e Vitisë, në Qendrat e Votimit QV nr. 2605D/01R, 2605D/02R, 2605D/03R, 2605D/04R, 2605D/04D, 2617D/01R, 1267D/02R, 2617D/03R, 2617D/04D, 2609D/01R, 2609D/02R, 2609D/03D, 2608D/01R, 2608D/02R, 2614D01D, 2615D/01D, 2626D/01D, 2623D/01R , si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në apel nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar krahasimin e votave lidhur me mungesën e votave, sipas pretendimeve ankimore të parashtruara, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një apeli shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në apel dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i apelit, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i apelit nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon apelin si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

Anr.700/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*